

Këshillë për mjekim kundër morrave të kokës

Informacione për prindërit

Infektimi (ndotja) me morra mund të luftohet me sukses vetëm brenda familjes. Informacionet për metodat korrekte të mjekimit i gjeni në broshurën tonë „Fleta udhëzuese e përgjithshme“ në faqen e Internetit: www.ag.llv.li. Kontrollojeni me kujdes tërë familjen Tuaj.

Në rast dyshimi për morra të kokës, drejtoritë e kopshteve për fëmijë dhe drejtoritë e shkollave fillore mund të kërkojnë angazhimin e ekipeve frontale (personat që morritin – shohin nëse dikush ka morra). Nëse te fëmija Juaj do të gjenden (konstatohen) morra dhe/ose thërija, atëherë Ju **patjetër** do të duhet të bëni mjekimin (trajtimin) kundër infektimit me morra të kokës. Ju lutemi që të veproni sipas këshillave të mëposhtme.

Edhe sikur Ju vetë gjatë kontrollit të flokëve me „krehër-gjuajtës të morrave“ të gjeni morra të gjallë dhe/ose thërija, atëherë **patjetër** do të duhet të bëni mjekimin (trajtimin) kundër infektimit me morra të kokës.

Këshilla për mjekim gjatë infektimit me morra


Dita 1:	Mjekim me preparate kundër morrave (shampon kundër morrave)
Dita 2 dhe 5:	Kontroll me krehër morrash dhe shpëlarje e flokëve
Dita 8:	Mjekim me preparate kundër morrave (shampon kundër morrave)
Dita 9 dhe 12:	Kontroll me krehër morrash dhe shpëlarje e flokëve
Dita 15:	Mjekim me preparate kundër morrave (shampon kundër morrave)
Dita 16 dhe 19:	Kontroll me krehër morrash dhe shpëlarje e flokëve
Dita 23 dhe 26:	Kontroll me krehër morrash dhe shpëlarje e flokëve

Shamponët kundër morrave nuk janë të përshtatshëm të përdoren si masa parandaluese, për shkak të zhvillimit të rezistencës!

Këtu mund t'i shikoni thërijat në formë të zmadhuar si dhe morrat të paraqitura në forma të ndryshme.



Mjekimi do të jetë i suksesshëm nëse shamponi kundër morrave kombinohet me “krehri-gjuajtës të morrave”:



„Krehri-gjuajtës i morrave“: _____ për kontroll

„Krehri-gjuajtës i morrave“ ose „kontrolli përmes metodës me krehër morrash dhe shpëlarje të flokëve“ shërben në radhë të parë për t’i gjetur morrat në flokë. Përveç kësaj, kjo metodë pas një mjekimi i mënjanon morrat eventualisht të sapolindur, e kontrollojnë suksesin e mjekimit të ndonjë preparati kundër morrave, i largon edhe morrat të cilët sërish janë bartur dhe janë rritur, dhe gjatë trajtimit (gjuetisë) dy herë në javë, cikli jetësor i morrit do të ndërpritet!

Krehri-gjuajtës i morrave për kontroll

- Në flokët e lagura mirë shpërndani një sasi normale të preparatit për mirëmbajtjen e flokëve (kondicioner, balsam flokësh etj.). Kjo gjë ua vështirëson lëvizjen morrave që eventualisht kanë mbetur dhe krehri i morrave do të lëvizë më lehtë nëpër flokë.
- Drejtoni (shkoklavitni) flokët me një krehër normal.
- Me krehrin e morrave krihni tani sistematikisht tërë flokët. Tërhiqeni krehrin e morrave nëpër flokë me një shtypje të lehtë mbi lëkurën e kokës. Fshijeni krehrin me një letër kuzhine në mënyrë të përsëritshme. Nëse në krehrin e morrave nuk ngjitet më asgjë, atëherë vazhdoni krehjen në pjesët e tjera të flokëve.
- Kur tërë flokët të jenë krehur në këtë mënyrë, atëherë flokët mund të lahen/shpëlahen me kondicioner apo balsam flokësh dhe të thahen si zakonisht.
- Metodën e krehjes me „krehër-gjuajtës të morrave“ përsëriteni të paktën dy herë në javë brenda një muaji ose të paktën 2 javë derisa të mos gjeni më morra.
- **Këtë trajtim (mjekim) bëjeni një herë në javë si masë parandaluese, dhe kështu me kohë do të zbuloni ndonjë infektim (ndotje) të sërishëm me morra, përpara se morrat të mund të shpërndahen.**

Nga aspekti mjekësor nuk është me rëndësi fakti nëse një fëmijë, a duhet të dërgohet në shtëpi menjëherë pasi të zbulohet infektimi me morra apo pasi të mbarojë shkolla. Pasi të kryhet trajtimi i parë mjekësor, fëmija do të duhet që sërish ta ndjekë mësimin (edhe ushtrimet e gjimnastikës dhe të notimit). Kjo do të thotë se, nëse një fëmijë nuk mund të mjekohet menjëherë, ai për shkaqe sigurie duhet të qëndrojë larg mësimin (ambienteve shkollore), që mos t’i rrezikojë shokët e tij të shkollës.

Vizita e hapësirave (kampeve) shkollore është e vështirë (delikate), sepse mjekimi i mëtejshëm gjatë kohës së qëndrimit në kamp (shkollë) duhet të jetë në përputhje me rekomandimin për përdorim.

Nëse keni pyetje të tjera, drejtohuni te Enti për Shëndetësi ose te mjeku apo mjekja Juaj për fëmijë.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin Tuaj aktiv.

AMT FÜR GESUNDHEIT



AMT FÜR GESUNDHEIT
FÜRSTENTUM LIECHTENSTEIN